



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7, nenin 25 dhe nenin 42 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L-185);
- Dispozitat ligjore të Rregullës për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- Dispozitat ligjore të Rregullës për vënien e çmimeve të Furnizuesit Publik për Energji Elektrike;
- Vendimin V_393_2011 të datës 29.12.2011;
- Dokumentin për Përcaktimin e vlerës indikative të Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit; dhe
- Dokumentin për Caqet indikative të Humbjeve në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes;

në seancën e mbajtur me datë 06 shkurt 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I.** Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit të jetë 15% nominale (përfshirë inflacionin prej 3%) për periodën tranzitore dhe për shqyrtimin e ardhshëm periodik (1+5 vjet), me supozimin se leverazhi (gearing-u) është 50%.
- II.** Lakorja e reduktimit të humbjeve në shpërndarje do të fillojë nga vlera e realizuar në vitin 2011 dhe do të reduktohet për 3% (pikë përqindjeje) në 3 vitet e para dhe për 2.5% (pikë përqindjeje) në 3 vitet pasuese. Faktori i ndarjes së humbjeve do të jetë 0%.
- III.** Niveli i Borxhit të Keq të jetë 5% për 3 vitet e para dhe 4% për 3 vitet pasuese.
- IV.** Faktori i efijencës do të jetë 0% për 3 vitet e para dhe më së shumti 5% për vit, për 3 vitet pasuese. ZRRE sugjeron që të konsultohet publiku para vendosjes definitive të caktimit për 3 vitet pasuese.

ARSYETIM

- o Pas konsultimit të rregullt me publikun, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2011, Bordi i ZRRE-së ka miratuar vlerat indikative për reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe vlerën indikative të mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit. Qëllimi i atij vendimi ka qenë reflektimi i vlerave të përafërta që janë konsideruar të arsyeshme për llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara, në pajtim me konkluzionet dhe komentet e pranuar nga palët e interesit.



- Më datë 24 janar 2012, ZRRE ka pranuar një shkresë nga Këshilltarët e Qeverisë për Transaksionin e KEDS-it lidhur me vlerat indikative të ZRRE-së. Në shkresën e tyre¹ e cila, sipas Këshilltarëve të Transaksionit, është hartuar me kërkesën e Ministrit për Zhvillim Ekonomik, ata theksojnë se vlerat indikative të përcaktuara nga Rregullatori nuk janë të mjaftueshme për të siguruar investime në KEDS, në pajtim me Strategjinë e Energjisë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

- V. Bordi i ZRRE-së i ka shqyrtuar dhe pjesërisht i ka marrë në konsideratë kërkesat e Këshilltarëve të Transaksionit dhe ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.

- VI. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar